

VENDIM
Nr.407, datë 22.4.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR BULQIZË-URA ÇERENECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private (objekte, kultura bujqësore), që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Bulqizë-Ura Çerenecit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objektet dhe kulturat bujqësore, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 9 369 474 (nëntë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 9 369 474 (nëntë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 5. Shpronësimi të fillojë më 22.4.2009 dhe të përfundojë më 15.7.2009.
 6. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “proces regjistrimi” ose “konfirmim ZRPP”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrin e pasurive në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR

“Bulqizë – Bllatë – Ura e Çerenecit”

Qarku Dibër, komunat: Fushë – Bulqizë; Zërçan

Lloji i pasurisë: kulturë bujqësore, kulturë drufrutore dhe objekte

Nr.	Pronari			Z.K	Nr.Pas.	Objekte Lloji	Vlera Leke	Kult. Bujq. V.L (Leke)	Dru Frut. V.L.(Leke)	Totali Leke	Fshati	Shenime
	Emri	Atesia	Mbimeri									
1	Pellumb	Mehmet	Boba	1532	528, 529				767566	767566	Dragu	Konfirmuar nga ZRPP
2	Muharem	Hamit	Zeneli	1660	11				391442	391442	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
3	Kujtim	Maliq	Kuka	1660	761				363328	363328	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
4	Fiqiri	Bilal	Gjura	1660	755				139809	139809	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
5	Hasan	Jonuz	Kica	1660	128				86158	86158	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
6	Shefqet	Hasan	Daka	1660	921				384749	384749	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
7	Mehmet	Hysen	Xhafa	1660	791				31410	31410	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
8	Arben	Isuf	Kola	1660	90	Shtepi Banimi	2379043			2379043	Fushe-Bulqize	Konfirmuar nga ZRPP
9	Ilmi	Tahir	Fiku	1824	97/6				127753	127753	Godvi	Konfirmuar nga ZRPP
10	Ismail	Aqif	Fiku	1824	29/4				230082	230082	Godvi	Konfirmuar nga ZRPP
11	Skender	Tahir	Fiku	1824	97/4				129082	129082	Godvi	Konfirmuar nga ZRPP
12	Aqif	Shaban	Fiku	1824	29/5				88470	88470	Godvi	Konfirmuar nga ZRPP
13	(B.Pr.) Ylli dhe Gezim Hoxha			3706		P.KARB+POLIGON	2581984			2581984	Valikardhe	Proçes regjistrimi
14	Ilmi	Hajdar	Tollja	3491	41/1	Nder.jashte funks	367488			367488	Sofraçan	Konfirmuar nga ZRPP
15	Sabri	Selim	Mera	2262	29/4,109/2			10631	39639	50270	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
16	Agim	Muharem	Kurcani	2262	111/1			12880	58804	71684	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
17	Dashamir	Dilaver	Mera	2262	109/1			2344	173068	175412	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
18	Dilaver	Jaho	Hoxha	2262	111/2			8438	160490	168928	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
19	Bajram	Dilaver	Mera	2262	29/8,29/10			19125	274115	293240	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
20	Beshir	Dan	Dervishi	2262	38/1				272708	272708	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
21	Xheladin	Tal	Mera	2262	100/8, 29/1			4463	23003	27466	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
22	Deshira, Argjentina		Mera	2262	29/7,29/9			21950	167286	189236	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP

23	Ali	Ferit	Mera	2262	98/1,110/9			3135		3135	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
24	Ali	Bajram	Nela	2262	99/2			2531		2531	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
25	Ismail	Asllan	Kurcani	2262	100/14,100/15			3175		3175	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
26	Xhezmi	Ali	Mera	2262	114/4			13781		13781	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
27	Feride	Xhemal	Beka	2262	115/6			2025		2025	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
28	Moiz	Hajredin	Beka	2262	115/7			2250		2250	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
29	Abaz	Hajredin	Beka	2262	115/8			3375		3375	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
30	Lutfi	Shaban	Kurcani	2262	115/3,126/9			3188		3188	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
31	Skender	Ali	Mera	2262	112/2,115/14	dhe 29/2		5744		5744	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
32	Muharem	Ali	Mera	2262	126/7,112/3			2218		2218	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
33	Mite	Sadik	Mera	2262	112/1			3469		3469	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
34	Illir	Ramadan	Lami	2262	115/17			2475		2475	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
35	Petrit	Shaban	Kurcani	2262	115/4			1500		1500	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
36	Lutfie	Rifat	Cani	2262	115/15			3300		3300	Krajke	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI					5328515	131997	3908962	9369474		

